



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teori Letërsie

Ngarkesa: 4 ECTS, 30 orë leksione, 10 orë seminare

Viti / Semestri : Viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor - Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez (filierat: Gjuhë, Komunikim, Përkthim dhe Interpretim)

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti fillimisht duhet të njohë atë çka vjen nga letërsia në përgjithësi : autori, vepra, raporti midis autorit dhe lexuesit, autorit dhe veprës, personazhi, teoritë e ndryshme të recepsionit ose nivelet narrative, etj. E rëndësishme është t'u bëhet e qartë studentëve se letërsia është, para së gjithash, fiksim, trillim, fantazi dhe pavarësisht « kompleksit » që ajo ka kundrejt realitetit, si imitim, si referencë, apo si frymëzim, mbetet një art si gjithë të tjerët, që merr frymë veçse nëpërmjet kenaqësisë që i jep lexuesit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të kuptojë elementet teorike që ofrohen
2. Të dijë t'i kategorizojë saktë ata nëpërmjet shembujve
3. Të mundësojë interpretimin, analizën letrare nëpërmjet termave dhe nocioneve të përftuara gjatë lëndës

Teoria e letërsisë është studimi nëpërmjet shkencës i letërsisë si fenomen kulturor. Bëhet fjalë për një disiplinë që buron sa nga gjuhësia aq edhe nga estetika.